



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 26 maj 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buçinca, Hajdin Abazi, Ali Lajçi, Anita Morina, Synavere Rysha, Radmila Vujovic, ndërsa munguan: Melihate Tërmkolli, Rasim Selmanaj

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Drita Morina – zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative

Mbledhjen e kryesoi z. **Esat Brajshori**, kryetar i Komisionit, i cili propozoi këtë

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. L – 062/1, para miratimit në parim.
3. Realizimi i vizitave të Komisionit në terren dhe monitorimi i ligjeve.
4. Të ndryshme.

1. Pika e parë e rendit të ditës -

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Pika e dytë e rendit të ditës –

Kryetari i komisionit hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

Fehmi Mujota - tha se, P/ligji në fjalë në Kuvend vjen për shqyrtim e miratim pas vendimit që Kuvendi ka marrë për përkrahjen e Komisionit për regjistrimin civil.

Ai, propozoi që P/ligji i plotëson kriteret për miratim në parim, ndërsa vërejtjet dhe plotësimet mund ti japim në seancën plenare dhe në fazën e amendamentimit.

Esat Brajshori - tha se P/ligji është shumë i rëndësishëm me faktin se definojnë funksionalitetin e statistikave të Republikës së Kosovës, por P/ligji shoqërohet me mangësi dhe kundërshtim të vet neneve. Ai theksoi, me një –po – të zbehtë, miratimin në parim të P/ligjit duke propozuar formimin e një grupi punues brenda komisionit, i cili grup do të merrej me shqyrtimin dhe amendamentimin e P/ligjit.

Pas diskutimeve komisioni votoi, njëzëri që P/ligji për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës mund të procedohet për miratim në parim në seancën plenare.

3. Pika e tretë e rendit të ditës

Esat Brajshori – i njoftoi anëtarët e komisionit për vizitat në komuna konform përfundimit që komisioni kishte nxjerr në njërën nga mbledhjet e kaluara.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, hapi diskutim.

Ali Lajçi – kërkoi të rritet numri i komunave të cilat do të vizitohen duke propozuar të vizitohet Mitrovica dhe Peja.

Hajdin Abazi – propozoi të vizitohen ato komuna të cilat nuk janë vizituar më parë dhe konfirmoi se komisioni është marrë vesh për çështjen në fjalë.

Fehmi Mujota - propozoi që në fazën e parë të vizitohen pesë komuna pastaj në një fazë tjetër të vizitohen edhe komunat tjera.

Radmila Vujovic – shprehi mendimin duke propozuar që komisioni të ndahet në dy grupe në mënyrë që brenda një jave do të mund ti vizitonte dy komuna.

Fehmi Mujota –tha se, nga praktikat e kaluara komisioni në përbërje të plotë i realizon vizitat në komuna .

4. Pika e rendit të ditës – të ndryshme –

Anita Morina – pyeti, lidhur me shqyrtimin e raportit të RTK-së.

Esat Brajshori – iu përgjigj - në mbledhjen e radhës do të shqyrtohet, pasi që raporti ka arritur pasi komisioni ka thirr mbledhjen.

Përgatitur nga

Zyra kordinuese e Komisionit

Esat Brajshori